**REPUBLIKA SHQIPERIA**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**Nr.** 1102 **Rep.**
**Nr.** 2073 **Kol**

# KONTRATE DHURIMI AKSIONESH

Sot, më datë ____.2007, në zyrën e Noterisë Tirane, përpara meje Noteres ____________ u paraqiten personalisht të interesuarit si më poshtë me cilësinë e dhuruesit dhe pranuesit të dhurimit të cilët në bazë të nenit 761 e vijues të Kodit Civil si dhe Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992, "Për shoqëritë tregtare" kërkuan redaktimin e kësaj kontrate si vijon:

**Dhuruesi:** **Z. Sabahudin Dollaku, lindur në Tivar (Ulqin), me 28.04.2958, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës nr. Z1574250, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;**

dhe

**Pranuesi:** **Z. Hysen Ruka, lindur në Kukës, më 27.02.1960, banues në Tiranë, pasaportë nr. Z1261420, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.**

**OBJEKTI:** Dhurimi i 1.440 (një mijë e katërqind e dyzetë) Aksioneve të shoqërisë "LANDESLEASE" SH.A. që i përkasin aksionarit Sabahudin Dollaku në favor të aksionarit Hysen Ruka.

Sipas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur deri në ditën e sotme të shoqërisë "LANDESLEASE" SH.A. shoqëri kjo është regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. 33307, datë 05.04.2005.

Në mbështetje të Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992, "Për shoqëritë tregtare" dhe të statutit të shoqërisë tregtare "LANDESLEASE" SH.A. Dhuruesi Sabahudin Dollaku i cili zotëron 1.440 (një mijë e katërqind e dyzetë) Aksione me vlere nominale Lekë 1.000 (një mijë) secili, që përfaqësojnë 3% të kapitalit të Shoqërisë LANDESLEASE SH.A ia dhuron, duke ia kaluar në pronësi pa shpërblim, të gjitha këto aksione Pranuesit Z. Hysen Ruka, i cili pranon ato.

**Përfundimisht aksionarë të shoqërisë "LANDESLEASE" SH.A. do të jenë:**

1. Z. Hysen Ruka zotëron 31.600 (tridhjetë e një mijë e gjashtëqind) Aksione;
2. Z. Basri Rruka zotëron 11.920 (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzetë) Aksione;
3. Z. Ardian Kamberi zotëron 4.480 (katër mijë e katërqind e tetëdhjetë) Aksione;

Kontrata pasi iu lexua dhe u gjet në përputhje me vullnetin e palëve nënshkruhet rregullisht në praninë time nga Dhuruesi dhe Pranuesi dhe unë noterja legalizoj nënshkrimin sipas ligjit.

Kontrata u redaktua në katër kopje me fuqi të barabartë secila, ku njëra prej tyre arkivohet ne këtë zyre noteriale

| DHURUESI | PRANUESI |
|---|---|
| **SABAHUDIN DOLLAKU** | **HYSEN RUKA** |
| *(emër, mbiemër, firmë)* | *(emër, mbiemër, firmë)* |
| Sabahudin Dollaku | Hysen Ruka |